




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



REF: DATË/A:	Nr.ref.471/2023 24 Korrik 2023
PËR/ZA:	Z. Albin Kurti , Kryeministër i Republikës së Kosovës; Z. Besnik Bislimi , Zëvendës Kryeministër; Z. Xhelal Sveçla , Ministër i Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike; Znj. Albulena Haxhiu , Ministre e Drejtësisë; Z. Hekuran Murati , Ministër i Financave Punës dhe Transfereve;
NGA/OD:	Albert Zogaj , Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
TEMA/SUBJEKAT:	Letër e hapur: Pallati i Drejtësisë

Të nderuar,

Si pasojë e mos funksionimit të sistemit të klimatizimit në Pallatin e Drejtësisë dhe rritjes së temperaturës në ambientet e punës deri më 35 gradë celcius, në një takim të jashtëzakonshëm të mbajtur sot me datën 24 korrik 2023, Këshilli Gjyqësor dhe kryetarët e Gjykatave, që punojnë në Pallatin e Drejtësisë, kanë vendosur që t'ju drejtohen me këtë letër të hapur:

Edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, ndër vite, që bashkërisht me secilin nga përgjegjësit të punojmë për përmirësimin e kushteve elementare të punës në Pallatin e Drejtësisë, gjendja është përshkallëzuar edhe më tepër dhe tani kemi arritur në situatën që gjyqtarët dhe punonjësit e Gjykatës Supreme, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të Gjykatës së Apelit, të Gjykatës Komerciale dhe të Gjykatës Themelore të Prishtinës të punojnë në kushte alarmante të punës, si rezultat i mos funksionimit të sistemit të ajrosjes në Pallatin e Drejtësisë.

Siç të gjithë janë në dijeni, që nga ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë në Vitin 2010 përgjegjës për "mirëmbajtjen e higjienës" dhe "mirëmbajtjen teknike" është Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (ish MAP).

Në Vitin 2022 pas diskutimeve me personat përgjegjës në MAPB jemi pajtuar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të merr përsipër mirëmbajtjen e higjienës, por paraprakisht të bartet buxheti i domosdoshëm nga MAPB në KGJK dhe kjo nuk ka ndodhur as me Ligjin për Buxhet të Vitit 2023. Edhe pse përgjegjës në MAPB ishin në dijeni se KGJK nuk ka buxhet të dedikuar për mirëmbajtjen e Pallatit të Drejtësisë, në muajin Maj 2023 kanë informuar Sekretariatit të KGJK se kontrata për "mirëmbajtjen e higjienës" e lidhur mes MAPB dhe një kompanie private ka skaduar dhe nga ajo ditë MAPB nuk merr asnjë përgjegjësi.

Si pasojë e kësaj, Këshilli Gjyqësor ka mbetur i vetëm në përpjekjet për të gjetur një zgjidhje, ku të gjendur në këtë situatë u është drejtuar me lutje gjyqtarëve dhe stafit që vet të kujdesën për higjienën deri në gjetjen e një zgjidhje.

Ndërsa, me datë 19 korrik 2023, Këshilli Gjyqësor është informuar se edhe kontrata tjetër e MAPB për “mirëmbajtjen teknike” ka skaduar (që përfshin edhe klimatizimin) dhe si pasojë menjëherë të nesërmen temperaturat në hapësirat në Pallat kanë arritur në nivelin prej 35 gradë celcius, që është e pa përballueshme dhe e dëmshme për shëndetin e punonjësve dhe palëve në procedurë.

Të gjendur në këtë situatë, Këshilli Gjyqësor në koordinim me Kryetarët e Gjykatave që punojnë në Pallatin e Drejtësisë është i detyruar që në takimin e paralajmëruar për datën 25 korrik 2023 të merr vendim për ndërprerjen e punës deri në përmirësimin e gjendjes teknike ose rënies së temperaturave.

Duke shpresuar që do të ndërmerrni masa të menjëhershme, ju siguroj për gatishmërinë e Këshillit Gjyqësor për të bashkëpunuar me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe krijimin e kushteve elementare për punë, në të kundërtën do të dëmtohen një numër i konsiderueshëm i proceseve gjyqësore në zhvillim e sipër dhe rrjedhimisht do të pamundësohet çdo shërbim për qytetarët.

Me respekt,
Albert Zogaj